



PPSH (Pyetjet e parashtruara më shpesh)

**PËR PROCESIN E
TRANZICIONIT TE
PERSONAT
TRANSGJINOR**





1. Çfarë është transgjinia?

Seksi është një grup i karakteristikave seksuale trupore dhe gjenitale, si dhe karakteristikave sekondare seksuale. Seksi regjistrohet në lindje si një përcaktues biologjik sipas anatomisë së dukshme.

Gjinia është një manifestim sociologjik dhe kulturor i një identiteti të krijuar nga ideja shoqërore e të kuptuarit se çfarë do të thotë të jesh burrë, grua, asnjëra, ose një përzierje e të dyjave.

Identiteti gjinor është një manifestim i gjinisë personale përmes ndjenjës së brendshme të vetvetes ose me fjalë të tjera identifikimi personal i gjinisë. Identiteti gjinor nuk është i dukshëm për të tjerët.

Shprehja gjinore është mënyra se si njerëzit e shprehin identitetin gjinor përmes emrit, përemrave, veshjeve, sjelljes dhe karakteristikave të tjera gjinore.

Gjinia mund të përkojë ose jo gjithmonë me seksin biologjik dhe ekziston pavarësisht nga seksi. Kur seksi dhe gjinia përputhen, fjala është për cisgjini dhe është një person cisgjinor, dhe nëse në ndonjë mënyrë gjinia dhe seksi nuk përkojnë, është çështje transgjimore dhe është person transgjinor.

- **Transgjinia** është një term
- gjithëpërfshirës dhe përfaqëson
- identitetin e një personi transgjinor,
- gjinia e të cilit nuk përputhet me seksin
- e regjistruar në lindje, si dhe të atyre
- personave që shprehen ose duan të
- shprehen në një mënyrë tjetër nga
- seksi i regjistruar në lindje. Personat
- transgjinorë që kanë nevojë dhe do të
- vendosin të pajtojnë karakteristikat e
- tyre të jashtme dhe/ose të brendshme
- gjinore dhe shprehjen e tyre gjinore me
- identitetin e tyre të brendshëm gjinor
- kalojnë nëpër një proces tranzicioni
-
-
-
-



2. Çfarë paraqet procesi i tranzicionit te personat transgjijor?


Tranzicioni është procesi me të cilin transgjijorët harmonizojnë karakteristikat e brendshme dhe të jashtme të gjinisë me shprehjen e tyre gjinore. Tranzicioni ndihmon personat transgjijorë të shprehin identitetin e tyre gjinor në masën që ata vendosin vetë. Kalimi mund të bëhet përmes një procesi të konfirmimit mjekësor të gjinisë, përmes njohjes ligjore të gjinisë, tranzicionit shoqëror ose përmes një kombinimi të disa hapave, të cilat ndryshojnë nga personi në person dhe jo të gjithë transgjijorët vendosin të ndërmarrin të gjithë hapat. Tranzicioni si proces është i gjatë dhe kompleks, por edhe ekskluzivisht subjektiv, sepse, mbi të gjitha, bazohet në nevojat personale, pritjet dhe vetë-perceptimin.

2.1 Vërtetimi mjekësor i gjinisë

Vërtetimi mjekësor i gjinisë është harmonizimi i karakteristikave të brendshme dhe të jashtme të gjinisë me identitetin e vet gjinor me ndihmën e terapisë hormonale dhe kirurgjisë. Ky proces tranzicioni mund të përfshijë mbështetje psiko-sociale, terapi hormonale, kirurgji ose një kombinim i ndërhyrjeve dhe trajtimeve të shumta mjekësore. Përmes këtij procesi, personat transgjinatorë zakonisht ndryshojnë karakteristikat e tyre fizike në përputhje me identitetin e tyre gjinor.

2.2 Njohja ligjore e gjinisë

Njohja ligjore e gjinisë është një proces në të cilin transgjinatorët zyrtarisht ndryshojnë të dhënat personale duke iu referuar një gjinie në dokumentet e tyre personale. Ky proces mund të përfshijë disa procedura ligjore si ndryshimi i emrit dhe mbiemrit, ndryshimi i shenjës për seksin ose numrit amë në dokumentet e identifikimit personal. Sipas ligjeve aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, emri dhe mbiemri mund të ndryshohen, por meqenëse ende nuk ka kornizë ligjore për njohjen ligjore të gjinisë, nuk ka mundësi të ndryshohet shenja për seksin ose numrin amë.



3. Tranzicioni social

Disa nga hapat që mund t'i ndërmerrni në procesin e tranzicionit kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin jetoni, punoni dhe shpreheni. Këto hapa mund të përfshijnë ndarjen me familjen, miqtë dhe kolegët, duke përdorur emrin e zgjedhur dhe adresimin e gjinisë së duhur, si dhe ndryshimet e emrit dhe/ose përcaktimet për seksin në dokumentet e identifikimit personal përmes proceseve ligjore të njohjes së gjinisë.

4. Vërtetimi mjekësor i gjinisë

Çdo person transgjinnor që dëshiron të fillojë një **proces tranzicioni me vërtetim mjekësor** gjinnor ka nevojë për një ekip mjekësor (i përbërë nga një mjek i familjes, psikiatër/psikolog, internist dhe specialist si gjinekolog dhe endokrinolog). Ky ekip duhet të sensibilizohet për të punuar me persona transgjinnorë, por gjithashtu i njoftuar me nevojat kryesore dhe problemet me të cilat përballet komuniteti transgjinnor. Ekipi mjekësor është ai që monitoron tranzicionin duke u udhëhequr nga parimet profesionale dhe nevojat individuale të personit transgjinnor. Ju dhe ekipi mjekësor përcaktoni hapat më të përshtatshëm të tranzicionit.

4.1 Këshillimi dhe mbështetja psiko-teapeutike

Psikoterapia është një trajtim i bazuar në një bisedë midis një psikoterapeuti dhe klientëve, i cili synon të përmirësojë mirëqenien dhe shëndetin mendor të një personi, për të eliminuar ose kontrolluar simptoma shqetësuese, vështirësi emocionale ose çrregullime. Psikoterapeuti siguron një mjedis mbështetës që ju lejon të flisni hapur për arsyet pse mendoni se keni nevojë për këshillim ose psikoterapi. Gjatë psikoterapisë, zhvillohet vetëdija për gjendjen tuaj të brendshme, ndjenjat, mendimet dhe sjelljen. Psikoterapia ju ndihmon të mësoni se si t'i përgjigjeni situatave sfiduese me aftësi të shëndetshme të përballimit.

Kërkimet tregojnë se shumica e njerëzve që janë pjesë e procesit psikoterapeutik përjetojnë lehtësim të simptomave dhe janë më të aftë të funksionojnë në jetën e tyre të përditshme. Përfitimet përfshijnë gjithashu më pak probleme shëndetësore, rritjen e kënaqësisë në punë dhe zgjidhjen më funksionale të problemeve.

Vizitoni një psikoterapist me të cilin do të ndiheni të lirë, të jeni të hapur dhe të sinqertë, sepse sukcesi i terapisë varet nga kjo. Ndiqni planin e rënë dakord me psikoterapistin dhe punoni në detyrat dhe ushtrimet ndërmjet seancave, nëse terapeuti jua ka dhënë.

4.2 Terapia hormonale

Terapia hormonale është pjesë e një tranzicioni mjekësor në të cilin një person transgjinator përdor hormone për të sjellë trupin e tij ose të saj më afër gjinisë me të cilën identifikohet. Terapia hormonale mund të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e tranzicionit fizik dhe psikologjik të personave transgjinatorë. Trajtimi hormonal është individual, në varësi të qëllimeve dhe aftësive të individit, marrëdhënies midis rrezikut dhe përfitimit, pranisë së kushteve të tjera mjekësore, si dhe kushteve sociale dhe ekonomike.

Hapat për të filluar trajtimin e terapisë hormonale

Çdo person transgjjinor që dëshiron të fillojë terapinë me hormone duhet të përcaktojë hapat dhe mundësitë për tranzicion së bashku me një ekip mjekësor. Ndërsa terapia hormonale për gratë transgjjinore ndryshon nga terapia hormonale për burrat transgjjinorë, kështu që bëni hapat për të filluar trajtimin me të.

Një grua transgjjinore ose trans grua është një term që mund të përdoret nga personat të cilëve u është caktuar një seks mashkullor në lindje, por identifikohen si gra. Disa prej tyre preferojnë të quhen thjesht gra, pa shpjegime të mëtejshme. Është më mirë të thuash dhe të zgjedhësh cilin term preferon.

Trajtimi me terapi hormonale te gratë transgjjinore

Për të filluar terapinë me hormone, së pari duhet të konsultoheni me mjekun tuaj të familjes, i cili do t'ju referojë të një psikolog/psikiatër për gjetjet dhe mendimet. Ky proces është individual dhe zgjat në varësi të vlerësimit personal të psikiatrit dhe rezultateve të testeve të psikologut. Me rezultatin e marrë, mjeku i familjes ju udhëzon te një internist i cili ju kontrollon dhe më pas ju udhëzon te një endokrinolog. Endokrinologu ju dërgon të bëni pasqyrë gjaku, kariotip dhe statusin hormonal. Bazuar në rezultatet, endokrinologu përcakton dozën e kërkuar dhe me një raport prej saj ju udhëzoheni tek mjeku i familjes për të përshkruar terapinë. Marrja e terapisë hormonale duhet të jetë nën

mbikëqyrje profesionale dhe të merret në përputhje me metodën e përshkruar.

Një burrë transgjinior ose trans burrë

është një term që mund të përdoret nga personat të cilëve u është caktuar një seks femër në lindje, por që identifikohet si mashkull. Disa prej tyre preferojnë të quhen thjesht burra, pa shpjegime të mëtejshme. Është më mirë të thuash dhe të zgjedhësh cilin term preferon.

Trajtimi me terapi hormonale te burrat transgjiniore

Për të filluar terapinë me hormone, së pari duhet të konsultoheni me mjekun tuaj të familjes, i cili do t'ju referojë të një psikolog/psikiatër për gjetjet dhe mendimet. Ky proces është individual dhe zgjat në varësi të vlerësimit personal të psikiatrit dhe rezultateve të testeve të psikologut. Me rezultatin e marrë, mjeku i familjes ju udhëzon te një gjinekolog, i cili ju kontrollon dhe më pas ju udhëzon te një endokrinolog. Endokrinologu ju dërgon të bëni pasqyrë gjaku, kariotip dhe statusin hormonal. Bazuar në rezultatet, endokrinologu përcakton dozën e kërkuar dhe me një raport prej saj ju udhëzoheni tek mjeku i familjes për të përshkruar terapinë.

5. Mbështetje nga komuniteti dhe kontaktet e dobishme

Nëse ndieni nevojën për të filluar një nga hapat e tranzicionit dhe ndiheni të gatshëm për të filluar procesin e tranzicionit, kërkoni këshilla ose përvoja nga njerëz të afërt, kontaktoni dhe bisedoni me njerëz të tjerë transgjnorë ose OJQ që punojnë me komunitetin LGBT, kërkoni ndihmë, këshillim, udhëzime dhe kontakte nga profesionistë, të cilët kanë përvojë pune me persona transgjnorë dhe janë të ndjeshëm ndaj problemeve dhe nevojave të personave transgjnorë.

- TransFormA është iniciativë e
- komunitetit të personave transgjnorë,
- që punon në realizimin e të drejtave të
- personave transgjnor dhe prezantimin
- e tyre me dinjitet, të cilëve po ashtu,
- mund t'u drejtoheni për këshillë dhe
- rekomandim.

Kontakti: transformamk@gmail.com



Autorë të broshurës: Predrag Jovanovski dhe Lila Miliq – TranFormA – Iniciativa për mbrojtje dhe avancimin e të drejtave të personave transgjinorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Redaktor i broshurës: Nenad Micov – Shoqata STAR-STAR Shkup

Përkthim: Gramoz Shabani

Ky publikim u hartua nga Shoqata për mbështetjen e punëtorëve të marginalizuar STAR -STAR Shkup në bashkëpunim me TransFormA - Iniciativa për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave transgjinorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe u botua në kuadër të programit rajonal "Qëndrueshmëria e shërbimeve për popullsitë kryesore në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore", të zbatuar nga Aleanca e shëndetit publik në konzorcium me "100 PËRQIND JETË" (Rrjeti ukrainas i personave me HIV), Shoqata e Azisë Qendrore për HIV dhe Koalicioni Euroaziatik i Popullsisë Kryesore me mbështetjen e Fondit global për luftën kundër HIV, tuberkulozit dhe malarisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk mund të pasqyrojnë qëndrimet dhe mendimet e Fondit global për luftën kundër AIDS, tuberkulozit ose malarisë.

Fondi global për luftën kundër AIDS, tuberkulozit dhe malarisë nuk mori pjesë në koordinimin dhe miratimin e materialit direkt dhe përfundimet e mundshme të nxjerra prej tij.

KY PUBLIKIM ËSHTË PËR DISTRIBUIM FALAS.

The publication was created by Association for Support of Marginalized Workers STAR-STAR Skopje in collaboration with TransFormA – Initiative for Protection and Promotion of Transgender People's Rights in the Republic of North Macedonia and published within the framework of the regional project called "Sustainability of Services for Key Populations in Eastern Europe and Central Asia", which is carried out by the Alliance for Public Health, in a consortium with the CO "100 PERCENT LIFE" (All-Ukrainian Network of PLWH), the Central Asian HIV' Association and the Eurasian Key Populations Coalition with the support of the Global Fund to Fight AIDS, Tuberculosis, and Malaria.

Viewpoints presented herein are solely those of its authors and may not coincide with the views or opinions of the Global Fund to Fight AIDS, Tuberculosis, and Malaria.

The Global Fund to Fight AIDS, Tuberculosis, and Malaria did not take part in the coordination and approval of both the immediate material and the possible conclusions stemming from it.

THIS PUBLICATION IS FOR FREE DISTRIBUTION ONLY.



ИРВ КОЛЕКТИВ НА СЕКСУАЛНИ
РАБОТНИЦИ НА БАЛКАНОТ

TransFormA

SOS_
PROJECT

Alliance
for Public Health

CAAPL
Central Asian Association of PLWH

EURASIAN KEY POPULATIONS COALITION